MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Haftbrücke HB-350 Beton Kontakt: Astar special i bazuar në rrëshirë sintetike, rërë të imët dhe fije të integruara të polipropilenit.

- Ngjitje të fortë dhe tharje të shpejtë
- I gatshëm për përdorim
- Lehtë aplikohet
- Përmirëson ngjitshmërinë e sipërfaqeve të lëmuara
- Jep shtresë themelore me teksturë të vrazhdë që ndikon si urë mes substratit të lëmuar dhe shtresave vijuese.

HAFTBRÜCKE HB-350 BETONKONTAKT

Përdorime të rekomanduara

Substrate të përshtatshme për aplikim të **MARMOFIX HaftbrückeHB-350 Beton Kontakt** janë sipërfaqe të lëmuara të betonit, elemente të para-fabrikuara të betonit, pllakat e gipsit, si dhe substrate tjera të lëmuara. Jep ankorim të përkryer të llaçeve gips-gëlqerore dhe çimento-gëlqerore në sipërfaqe të lëmuara dhe me absorbim të ulët, të betonit dhe elementeve të para-fabrikuara të betonit. Gjithashtu përdoret si bazë për ngjitje në sistemet pllakë mbi pllakë.

...GARANTIERTE
QUALITÄT!

www.marmofix.ch

Marmofix DOOEL Chelopek, Brvenica
Address: 101 Str, No. 3, Chelopek, 1216
Tetovo, R. North Macedonia
Tel: +389 75 211 222

MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

HAFTBRÜCKE HB-350 BETONKONTAKT

Technical characteristics

Rrëshira	Kopolimer Stiren-akrilik
Dendësia	1,50±0,05 gr/ml
Viskoziteti	20.000±2.000mPas 23ºC
Harxhimi	Varësisht nga absorbimi dhe porozitetiI sipërfaqes: 0.25–0.30 kg/m^2

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

- Përgaditja e substratit
  Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe dobët të ngjitur për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Shtresat e vjetra që shkëputen lehtë duhet të largohen. Përmbajtja e lagështisë nën sipërfaqe (p.sh., beton) duhet të jetë maksimum 3%.
  Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.
- Përgaditja dhe aplikimi
  Metoda e aplikimit: Furçë, rul
  Hollues: Ujë
  Hollimi: Gati për përdorim
  Pas përzierjes së mirë, MARMOFIXHaftbrücke HB-350 Beton Kontakt aplikohet në një shtresë.
  Aplikimi nuk duhet të bëhet nën temperaturë+5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të githa aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Pastroni veglat me ujë menjëherë pas përdorimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me MARMOFIX Haftbrücke HB-350 Beton Kontakt. Kur produkti aplikohet me spërkatje, përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore.
Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake.
MARMOFIX Haftbrücke HB-350 Beton Kontakt duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, MARMOFIX Haftbrücke HB-350 Beton Kontakt mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kofa 20 kg